

20210771177

L I G J
PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT TË FINANCIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES
LOKALE

Neni 1

Në Ligjin e Financimit të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 61/2004, 96/2004, 67/2007, 156/2009, 47/11, 192/15, 209/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 244/19), pas nenit 22, shtohet nen i ri 22-a, si vijon:

„Neni 22-a

Buxheti i komunës për vitin 2021

Me përjashtim të nenit 22, paragrafi (2) të këtij ligji, të ardhurat vetjake në buxhetin themelor të komunës mund të planifikohen me rritje më së shumti deri 50% nga të ardhurat mesatare të realizuara në tre vitet e fundit, sipas të dhënave nga evidenca e thesarit.

Nëse në fund të vitit fiskal komunat kanë realizuar tepriçë në llogaritë për bllok dotacionet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, e me këtë rast institucionet publike që financohen nga bllok dotacioni nuk kanë detyrime të pashlyera, atëherë komuna, me Vendim të Këshillit të Komunës, këto mjete mund t'i transferojë në llogarinë e buxhetit themelor për financimin e kompetencave të saj ose në llogari të veçantë me dedikim për financim të ndonjë projekti ose aktiviteti konkret, me pëlqim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut paraprakisht të siguruar“.

Neni 2

Dispozitat nga neni 22-a i këtij ligji do të zbatohen në periudhën 1 janar 2021 - 31 dhjetor 2021.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".